



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

Numri i lëndës: 2022:228310

Datë: 11.03.2024

Numri i dokumentit: 05433000

P.nr.1266/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Gani Kastrati, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Erzana Hameli- Mustafa, në çështjen penale kundër të akuzuarit H.Sh., nga Prizreni, për shkak të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 pika 1.4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren- Departamenti i Përgjithshëm, PP/IL.nr. 2045-12/2022 të datës 06.12.2022, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor, në seancë publike, në praninë e prokurorit të shtetit Besim Susuri, të dëmtuarit E.K., përfaqësuesi i tij Av. A.Q., nga Prizreni, i akuzuari H.Sh., me mbrojtësin e tij Av. B:S., nga Prizreni më datë 20.02.2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari :

H.SH., nga i ati, e ëma, e lindur, i lindur më, në Prizren, ku edhe tani banon në rr “” nr. ... lagja Tusuz, ka të kryer shkollën fillore, punëtor, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës,

ËSHTË FAJTOR

Se me datë 17.10.2022, rreth orës 17.30min, në rr.”Ekrem Rexha” në Prizren, saktësisht ne pompën e derivateve “.....”, i pandehuri H.Sh., i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ja dëmtojnë shëndetin të dëmtuarit E.K., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje në lidhje me furnizim me derivate, ditën kritike derisa i pandehuri në cilësinë e punëtorit të kësaj pompe, ishte duke ia mbushur një klienti motorin me benzinë, nga pakujdesia i rrjedh benzina jashtë motorit ashtu që në atë moment reagon i dëmtuari E duke i thënë se “bos maqinës nuk i qitet benzinë se maqina e nxehtë kallet” dhe pas një konflikti verbal mes tyre, i pandehuri ne gjendje te revoltuar nxjerr nga xhepi një mjet të mprehtë - brisk, mjet ky i rrezikshëm për shkaktimin e lëndimit të rënd trupor, shkon tek i dëmtuari i cili ishte ne automjetin e tij dhe me brisk e godet te dëmtuarin një herë ne parakrahun e djathtë, duke i shkaktuar kështu dërmishje dhe gërvishnje lëkurore si dhe plagë shqyerës – ndrydhëse te indeve të bura ne regjionin e parakrahut të dorës së djathtë, gjendje kjo e konstatuar nga akt ekspertiza mjekoligjore e Dr.V.H., datës 04.11.2022.

Këso dore ka kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 par.2 lidhur me par.1 pika 1.4 të Kodit nr. 06/L-074 Penal të Republikës së Kosovës (KPRK).

Andaj, gjykata në kuptim të nenit 7, 17, 38,39, 40, 43, 44 69,70 të KPRK-së dhe nenit 360 par 1 dhe nenit 364 të KRPPK-së nr. 08/L-032 (KPP), të akuzuarit shqipton :

DËNIM ME KUSHT

Duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat verifikimi prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen vepër të re penale.

Në bazë të nenit 366 par 3 të KPRK-së nga i akuzuari konfiskohet 1(një) brisk me dorëz të zezë dhe me teh në gjatësi prej 5 cm

I dëmtuara E.K., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest te rregullt juridike- civile.

I akuzuari OBLIGOHET që ti paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 euro, në emër të ekspertizës mjeko-ligjore të paguaj shumë prej 20 euro, si dhe në emër të kompensimit të viktimave, të paguaj shumë prej 20 euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren, pranë kësaj gjykate ka parashtruar aktakuzën, PP/II. nr. 2045-12/2022 të datës 06.12.2022, ndaj të akuzuarit H.Sh., nga Prizreni, për shkak të dyshimit të bazuar mirë se ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par2 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPRK-së.

Gjyqtari i vetëm gjykues me datë 20.02.2024 ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin gjyqësor, në të cilin shqyrtim të akuzuarit H.Sh., pas udhëzimeve të dhëna nga gjykata, konsultimeve, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë, vullnetarisht ka pranuar fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barrë, andaj gjykata ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit Besim Susuri në fjalën përfundimtare ka theksuar se me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në tërësi vërtetohet gjendja faktike e përshkruar më persë afërmi si në dispozitiv të aktakuzës me këtë edhe fakti se i pandehuri H.Sh., ka kryer veprën penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185.par.2.lidhur me par. 1.nën par. 1.4. të KPRK-së me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimin si rrethanë lehtësuese gjykata ta merr parasysh pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit e gjithashtu si rrethanë lehtësuese ta ketë parasysh edhe deklaratën e përfaqësuesës e të dëmtuarit av. A.Q., në mungesë e të dëmtuarit.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit E.K., av. A.Q., në fjalën përfundimtare deklaruar se pas konsultimeve të mjaftueshme me të dëmtuarin heqim dorë nga ndjekja penale ndaj të pandehurit, nuk do të ushtrojmë padi civile për kompensimin e dëmit.

Mbrojtësi i të dëmtuarit H.Sh., av. B:S., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se pas konsultimeve të mjaftueshme me të mbrojturin tim ku e kam njoftuar për benifitet e pranimit të fajësisë si dhe rrethanat lehtësuese nëse e pranon fajësinë. I njëjti e ka pranuar fajësinë, është penduar për veprimet e tija dhe njëherë i premtom gjykatës se veprimet e tilla të kundërligjshme nuk do të përsërisë. Andaj, i propozoj gjykatës që të i ketë si rrethanë lehtësuese rregullimin e raporteve me të dëmtuarin si dhe deklaramet e tyre në seancë të avokates mbrojtëse dhe palës së dëmtuar, prandaj i propozoj gjykatës që të i shqiptoj një dënim sa më të but duke pasur parasysh të gjitha të lartcekura.

I akuzuari H.Sh., në fjalën përfundimtare ka theksuar se : e pranon fajësinë sipas pikave të aktakuzës dhe dua të shtoj që për një veprim të tillë jam penduar shumë, shprehim kërkim falje këtu në seancë në prezencën e prindit e të dëmtuarit E.K., – R.K., dhe përfaqësueses së tij të autorizuar av. A.Q., dhe theksoj se deri te ky incident ka ardhur nga momenti i çastit pa ndonjë qëllim të veçantë, me të dëmtuarin kurrë më parë nuk kemi pasur probleme e as që e kam njohur, edhe njëherë i kërkoj falje për atë që ka ndodhur e falënderoj përfaqësuesen e të pandehurit avokaten A.Q., dhe prindin e të dëmtuarit që është prezent në seancë që tërhiqen nga ndjekja ime penale dhe heqin dorë nga ushtrimi i kërkesës pasurore juridike, hera parë është që kam ra ndesh me ligjin, premtoj dhe zotohem që në të ardhmen nuk do të përsërisë ndonjë veprim kundërligjor, jam i gjendjes së dobët ekonomikore materiale, jam i pa punë vetëm kur gjer punë me mëditje, mezi e siguroj ekzistencën e familjes dhe e lus gjykatën që të më shqiptoj një dënim më të but dhe ta merr deklaratën time si rrethanë lehtësuese dhe që të më shqiptoj dënim sa më të but.

Gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka miratuar pranimin e fajësisë, ngase ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 322 lidhur me 241 të KPPRK-së. Me rastin e pranimit të fajësisë, gjykata vërtetoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të akuzuarit, pranimi ka mbështetje në faktet dhe provat materiale që gjendjen në shkresat e lëndës si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike, dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 244 të KPPRK-së, për pushimin e procedurës penale, përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Bazuar në pranimin e fajësisë nga i akuzuari dhe konform nenit 322 lidhur me nenin 241 të KPPRK-së, gjykata nuk është lëshuar në procedimin e provave.

Gjykata në shqyrtim gjyqësor nga pranimi i fajësisë së të akuzuarit dhe provave materiale në shkresat e lëndës ka vërtetuar se me datë 17.10.2022, rreth orës 17.30min, në rr."Ekrem Rexha" në Prizren, saktësisht ne pompën e derivateve "Hib Petroll", i pandehuri H.Sh., i shkakton lëndime trupore dhe përkohësisht ja dëmtojnë shëndetin të dëmtuarit E.K., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje në lidhje me furnizim me derivate, ditën kritike derisa i pandehuri në cilësinë e punëtorit të kësaj pompe, ishte duke ia mbushur një klienti motorin me benzinë, nga pakujdesia i rrjedh benzina jashtë motorit ashtu që në atë moment reagon i dëmtuari E duke i thënë se "bos maqinës nuk i qitet benzinë se maqina e nxehtë kallet" dhe pas një konflikti verbal mes tyre, i pandehuri ne gjendje te revoltuar nxjerr nga xhepi një mjet të mprehtë - brisk, mjet ky i rrezikshëm për shkaktimin e lëndimit të rënd trupor, shkon tek i dëmtuari i cili ishte ne automjetin e tij dhe me brisk e godet te dëmtuarin një herë ne parakrahun e djathtë, duke i shkaktuar kështu dërmishje dhe gërvishtje lëkurore si dhe plagë shqyerës – ndrydhëse te indeve të bura ne regjionin e parakrahut të dorës së djathtë, gjendje kjo e konstatuar nga akt ekspertiza mjekoligjore e Dr.V.H., , datës 04.11.2022.

Andaj, kjo gjykatë duke u bazuar në ato që u thanë më lartë, ka vërtetuar gjendjen faktike se në veprimet e të akuzuarit, plotësohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par 2 lidhur me par 1 pika 1.4 të KPRK-së. Me këtë rast, gjykata të akuzuarin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin me kusht duke i vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 5 (pesë) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afat verifikimi prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin ndaj të akuzuarit, gjykata vlerësoi të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Gjykata ka vlerësuar si rrethanë posaçërisht lehtësuese pranimin e fajësisë në shqyrtim gjyqësor, kërkim faljen, pendimin dhe keqardhjen ndërsa si rrethanë rënduese gjykata mori parasysh rrethanat dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale, sipas bindjes së gjykatës dënimi i shqiptuar është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, gjendjen ekonomike dhe shkallën e përgjegjësisë së të akuzuarit. Andaj, gjyqtari i vetëm gjykues, konsideron se edhe me këtë dënim mund të arrihet qëllimi i dënimit, nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Në fund, gjykata ka marrë parasysh edhe sanksionet tjera penale të përcaktuara me KPRK, mirëpo ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar, në mënyrë të plotë dhe të drejtë mund të arrihet qëllimi i dënimit sipas nenit 38 të KPRK-së.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori në kuptim të nenit 449 dhe 452 par. 1 të KPP-së.

Vendimi mbi pagesën e taksës në emër të Programit për kompensimin e viktimave të krimit, është marrë në kuptim të nenit 36 par. 3 pika 3.1. të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimin për kërkesat pasurore juridike u mor në kuptim të nenit 457 të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRIZREN
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM , DIVIZIONI PENAL

2022:228310, 20.02.2024

B. Profesional
Erzana Hameli- Mustafa

Gjyqtari
Gani Kastrati

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj Gjykate Themelore